



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE

Referuar kërkesës për informacion drejtuar Koordinatorit për të Drejtën e Informimit më datë 25.06.2026 nga Z. Zef Ndoka bëjmë me dije si vijon:

Çështja ka ardhur në Platformën e Bashkëqeverisjes me datë 22.04.2026, me ID 937351, nga z.Zef Ndoka, me objekt kërkesën për informacion lidhur me ankimin administrativ pranë ASHK-së, Drejtoria e Përgjithshme.

Pas verifikimit paraprak të ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, bazuar në pikën 1 të nenit 40 të ligjit nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen ankesa iu delegua ASHK-së, e cila informoi se ankesa e ngarkuar në Platformën e Bashkëqeverisjes nuk plotësonte kushtet për t'u trajtuar si ankim administrativ nga ky institucion, duke dhënë këtë përgjigje:

"Nga verifikimi i kryer në Sektorin e Arkivë-Protokollit të Drejtorisë së Përgjithshme nuk rezulton të jetë administruar ne protokoll ankimi i z. Zef Ndoka dhe orientoi qytetarin ta paraqiste atë në rrugë zyrtare, nëpërmjet shërbimit postar". Kjo përgjigje iu komunikua qytetarit po me datë 22.04.2026.

Me datë 25.05.2026, qytetari rihapi ankesën duke bërë me dije se ankimin e kishte dërguar me postë më 23.04.2026, por nuk kishte marrë përgjigje. Me datë 02.06.2026, ASHK informoi se nuk rezultonte e depozituar fotokopja e dokumentit të identifikimit, e nevojshme për vijimin e shqyrtimit.

Me datë 10.06.2026, qytetari njoftoi se dokumentacioni shtesë ishte dërguar dhe mbërritur pranë institucionit më 05.06.2026. Ky informacion iu përcoll ASHK-së nga Platforma e Bashkëqeverisjes në respektim të afateve ligjore.

Më 25.06.2026, ASHK informoi se ankimi i z. Zef Ndoka është në shqyrtim brenda afatit, në zbatim të nenit 91 të Kodit të Procedurave Administrative, dhe kjo përgjigje iu komunikua qytetarit.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB) nuk ka kompetencë të shqyrtojë ankimet administrative ndaj ASHK-së, apo për të marrë vendime mbi ankimet administrative të paraqitura kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), por vetëm monitoron respektimin e afateve ligjore për kthimin e përgjigjeve nga institucioni përgjegjës.